

Procesverbal

Nga Mbledhja XI (e njëmbëdhjetë) e rregullt për vitin 2024 e Komitetit për Politikë dhe Financa , e mbajtur më datë: 17.12.2024

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën XI; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë! Mirë se erdhët në Mbledhjen XI të rregullt të KPF-së për vitin 2024. Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë! Para se ta qesim në votim, nëse ka dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës?

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë! Znj.Kryesuese, në materialin të cilin na keni dërguar janë shtatë pika, na kanë pru edhe për performancën. Shtesë na ka çue zyrtari. A do të jetë pikë e rendit të ditës dhe cila pikë e rendit të ditës do të jetë?

Arijeta Skeraj: Atëherë, Artan, nesër kjo do të jetë si kërkesë në seancë për me u fut si pikë e rendit të ditës. A doni me e rekomandue nesër për Kuvend, apo jo? Atëherë e qesim në votim. Besoj se ju ka ardhë të gjithëve asambleistëve, një kërkesë që për nesër në seancë është për performancën e Komunës së Dragashit. Kush është pro që kjo pikë sot të diskutohet dhe t'i rekomandohet Kuvendit? A ka kundër? A ka abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e futim edhe këtë pikë në rend të ditës. Atëherë, e qesim në votim rendin e ditës sipas materialit. Kush është pro këtij rendi të ditës? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Vazhdojmë me pikën e parë, a do dikush me e marrë fjalën lidhur me procesverbalin? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratojmë procesverbalin. Vazhdojmë te pika e dytë për shqyrtimin e materialit të Kuvendit. Fillojmë me pikën e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës për vitin 2025. Kush do me e marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e dytë. Vazhdojmë me pikën e tretë: Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Statutit të QKMF-së. Kush do me marrë me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Për këtë pikë të rendit të ditës unë do të jem shumë i shkurtër, se shumë herë i kam

harxhues fjalët unë me këtë drejtor. Z.Kryetar, sot është e katërta herë që diskutohet për këtë Statut. Ftesa e parë ka qenë më 10 korrik, ftesa e dytë ka qenë më 11 korrik, të nesërmen, si Statut final, hera e tretë ka qenë më 15 tetor, edhe hera e katër ka qenë më 5 dhjetor. Kryetar, ti je mjek, tri herë më ra një kandidat në lejen e vozitjes, e çojnë te psikologu ose te psikiatri. E jo një drejtor ose një Statut, se aty është shumë i rëndësishëm dhe është çelësi i punës së shëndetësisë në Komunën e Dragashit, ku ju udhëhiqni. Atëherë, të kisha rekomandue shumë thjesht, këtë drejtorin tënd – sot e kemi psikiatrin aty, edhe psikologun – njëfarë këshille me ia dhënë atij bre, se s'është në rregull ai. A po e bën për inat, a çka është puna, se s'un po e kuptoj unë, seriozisht. Sa herë po dalim me diskutue këtu, ai po më nxit hala sende më të këqija. S'e di nesër a do të kalojë, s'e di a i ka përmirësue krejt gabimet. Këto dy rekomandimet që t'i kanë dhënë këtë herën e dytë, besoj se i ka plotësue. Unë e di që herën e parë, në fillim, ka qenë ma mirë, po presioni politik nga disa delegatë këtu që të jetë në Nenin 13, Pika 4.2, ku thotë zëvendësdrejtori është nga komuniteti joshumicë, drejtori nga komuniteti shumicë, ose anasjelltas. Këtë pikë është dashtë me e hek edhe herën e parë, e keni pas të hequr, por e keni vu nga presioni politik, tash prapë po duhet me e kthye në vend. Është menaxhmenti kënd e vë drejtor aty, nuk është pa qare me e shti në Statut. Edhe një herë po të them, Dr.Rami Krasniqin e kemi aty, propozoja një këshillë pak le t'ia jep, se katër për një pikë të rendit të ditës me na pru këtu, kurrë s'ka ndodhë që 25 vjet në Komunë të Dragashit.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, të nderuar anëtarë të KPF-së, i nderuar Kabinet qeveritar dhe ju të tjerë! Lidhur me diskutimin e Artanit, është e vërtetë që për Statutin e QKMF-së në Dragash po diskutohet për herë të katërt, mirëpo tri herë na është kthye nga Ministria. Ju siç e dini, herën e fundit Ministria e Shëndetësisë na ka pru rekomandimet të cilat duhet t'i plotësojmë dhe t'i shqyrtojmë në Asamblenë Komunale, dhe të gjitha ato rekomandime që i ka pru herën e parafundit, DShMS-ja i ka plotësue edhe Asambleja Komunale i ka votue të gjitha. Mirëpo, në momentin kur është çue ky Vendim i Asamblesë edhe Statuti në shqyrtim të ligjshmërisë, Ministria e Shëndetësisë i ka pru edhe dy rekomandime tjera. Pra, këtu nuk është faji i kërkujt, as i QKMF-së, as i drejtorit, as i Asamblesë, mirëpo është faji të Ministria e Shëndetësisë e cila herën e parafundit i ka pru rekomandimet dhe ne i kemi plotësue, herën e parafundit këto dy rekomandime që i ka pru tash nuk kanë qenë, ju e dini të gjithë që këto nuk kanë qenë. Këto janë dy rekomandime të fundit që i ka pru dhe të cilat drejtorja i ka plotësue, edhe e ka pru Statutin për miratim përfundimtar. Derisa të miratohet dhe të hyjë në fuqi Statuti i ri, QKMF-ja e ka Statutin e vjetër edhe nuk ndonjë boshllëk sa i përket menaxhimit dhe funksionimit. Kështu që, edhe ideja që zv/drejtori të jetë nga komuniteti joshumicë, nëse drejtori është nga komuniteti shumicë, nuk ka qenë ide e keqe, ka qenë ide e mirë, mirëpo Ministria e ka pa të rrugës që ky rekomandim është antiligjor, edhe ne tash si Kuvend, ju si Asamble, duhet ta votoni që atë ta hiqni. Faleminderit!

Munir Jonuzi: E kam fjalën për arsyen se kam insistuar edhe në vendosjen e pikes 13 që zëvendësudrejtori i QKMF-së të jetë nga komuniteti joshumicë nëse drejtori zgjidhet nga komuniteti shumicë dhe anasjelltas. Mendoj se është një propozim i mirë, ajo që po përpiqet të bëjë Ministria e Shëndetësisë është e gabuar. Ne mund të bëjmë një Statut të vetëm për të gjitha komunat, por duhet të kemi parasysh të drejtat e komuniteteve joshumicë, të cilat janë të garantuara në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Promovimit të komunitetit joshumicë dhe në bazë të parimit të përfshirjes, barazisë, ku komunitetit joshumicë i mundësohet pjesëmarrja në kryerjen e funksioneve publike, në një nga vendet kryesore. Ky nen, qëndrimi im nesër do të jetë që të mos shfuqizohet dhe të mos pranohet rekomandimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe të luftojmë për ta mbajtur këtë nen, sepse është në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës. dhe si i tillë nuk bindesh me statutin e unifikuar. Le t'i kushtojnë vëmendje komunave si Dragashi, me të gjitha specifikat e tyre. Le të përfshijmë një nga ato specifika në Statut.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për pagesën e komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës.

Munir Jonuzi: Më vjen mirë që një vendim i tillë vjen në kuvend për arsyen se njerëzit duhet të paguhen për çdo aktivitet të bere. Anetar të KKS-së më janë ankuar pse nuk u paguhen shpenzimet e udhëtimit, mëditjet për pjesëmarrje në ato komisione. Nëse ka mundësi financiare, duhet të gjejmë një mënyrë për të paguar të gjitha mëditjet e prapambetura, pasi bëhet fjalë për pagesë retroaktive, ndoshta për të gjithë vitin 2024. Nëse krijohet një komision nga kuvendi, duhet të gjejmë një mënyrë për ta financuar atë.

Artan Loshaj: Unë qysh në fillim kërkoja një sqarim prej kryetarit, por masi është kjo pikë e rendit të ditës, se unë kam pas me diskutue edhe në eventuale, po e shfrytëzoj rastin këtu, kryesuese, ty edhe ish-kryesuesit me ju pyet. Atë Komisionin që e kemi bo, për qato pagat e mëditjet, ku ka mbet, se e keni nis edhe e thirrën zyrtarin këtu – Mujën – edhe s'po e di ku mbetët, e keni lënë në gjys. A bën një informatë? Nëse ka mundësi me na dhënë një përgjigje, ku keni mbërri, a keni me na dhënë dikush, a kemi me kthye dikush pare aty, me na dhënë njëfarë informate, se ashtu-ashtu kam pas me e bo në eventuale këtë pyetje. E jemja është me pyet.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Këtu, pasi është pika për komitetet, a mundesh me ia dhënë përgjigjen, masi je kryetar i Komisionit, apo dësh në eventuale?

Uran Halimi: Faleminderit, znj.Kryesuese! Më ka pyet më herët edhe z.Samidin për Komisionin në fjalë. Ne po marrim vendim për pagesë ose mospagesë të këtyre komisioneve, sidoqoftë për punën e

Komisionit për Paga i cili u formue, ka mandat deri në fund të mandatit të kësaj qeverisjeje. Për ecurinë edhe punimet, ti besoj që ke qenë pjesëmarrës edhe e dish – nuk është anëtar, është z.Nexhat Selaj, mundesh me e pyet meqenëse e ke bashkëpartiak – po edhe unë të sqaroj. Kemi bo një pjesë të punës, gati dy vjet janë hulumtue aty dhe është përmbledhë si pjesë e punimeve – një vjet e gjys. Kemi me vazhdue kismet edhe me pjesën tjetër, edhe gati kah fundi i qeverisjes duhet me dalë me një raport edhe me e kqyrë çka ka ndodhë edhe çka është t’u ndodhë. Se na s’mundim me dalë me një raport tash, se kemi edhe një vjet gati qeverisje. Po është shumë e sigurt që deri në fund të këtij mandati do ta nxjerrim një rezyme përfundimtare. Po zhag, se na qa kemi mandat, katër vjet kemi mandat. Me u pas krye mandati i atij Komisioni edhe ne e kemi lënë punën në gjys, atëherë mundish me na akuzue, po përderisa kemi ende afat edhe mandat unë po besoj se duhet me hulumtue gjithçka që ka ndodhë këtu. Krejt në fund atëherë, edhe i bëjmë edhe disa mëditje pak më shumë edhe po besoj që e kryjmë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Dragashit.

Munir Jonuzi: Unë kam një propozim, ai është që nesër të caktohet një minitakim me Kryetarin para seancën e kuvendit me përfaqësuesit e grupeve që veprojnë në këtë kuvend dhe të merren vesh se cilët përfaqësues do të jenë aty dhe në fund të kemi një propozimin dhe për të votuar atë propozim.

Artan Loshaj: z.Kryetar dhe znj.Kryesuese, unë sa e di – ishalla jam gabim – unë e di që ky Komision veç ka qenë i formuar, po nuk po di sa mandat ka pas. Edhe, në qoftë se këtë Komision e bëjmë na, në qoftë se është me ligj, po unë qysh po e shoh këtu, përpilimin e kësaj e kanë bo gabim, se unë e kam pyet edhe drejtorin e Urbanizmit. Unë e di që ky Komision ka qenë i formuar edhe ka njëfarë afati. Po në qoftë se e formoni të ri, sa afat do të ketë, a do të keni komision rezervë. Edhe, unë e di për performancë, kryetar, se si asambleist kam marrë vesh që për performancë ju duhen edhe disa emra të rrugëve dhe shesheve me i pas të gjinisë së kundërt, gjinisë femërore. Po në qoftë se nuk i bëjmë këto, bare listën rezervë ta kemi për performancë, se edhe ju delni mirë si qeveri. Edhe, unë qysh e kam pyet atë, më ka thënë është i përpiluar gabim, Komisioni ka qenë edhe është me afat, po ky Komision duhet me qenë komision rezervë. Tash s’po e di sa është i përpiluar, në qoftë se kam marrë informata gabim, gabim po e them këtu unë. Nesër i kam thënë me dalë edhe me na dhënë një sqarim. Këto komisione unë e di që janë të formuara dhe kanë afat derisa ke afat ti, deri në zgjedhjet tjera. Ky Komision duhet rezervë edhe me pas emërtime të gjinisë së kundërt, për sheshe, për rrugë e për rrugica. Për performancë e ka lyp edhe zyrtarja për Barazi Gjimore.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Pasi z.Muniri kërkoi që nesër të mbledhen shefat e grupeve, për me i qit anëtarët për Komision, unë s’kam pse i mbledhi, ju mundeni

me i mbledhë secili partitë e veta, për shembull LDK-ja, PDK-ja, VAKAT-i, edhe prej secilës parti me ma pru një emër. Nuk prish punë absolut, ajo nesër në Kuvend merret.

Munir Jonuzi: Këtë propozim e kam paraqitur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur në një nga seancat e Kuvendit, ku nuk kemi mundur të votojmë për një komision. Që gjithçka të ishte sipas letrës që përfaqësuesit e KQZ-së verifikuan mandatet, thjesht doja të shmangja incidente të tilla, që të mos qeshe populli me ne. Ne kishim të drejtën e 3 anëtarëve, ekzekutivi kishte 2, kështu që nuk do të humbim kohë. Nëse mbetet propozimi që të delegohen anëtarë në kuvend, atëherë do të kërkoja që kryesuesja të udhëhiqet nga letra që ka para vetes dhe të diskutojë me subjektet politike që janë në atë listë.

Arijeta Skeraj: Atëherë, z.Munir, unë problemin më të vogël e kam me fol me kryeshefat, edhe absolut unë në zyrë i pres. Por, asnjë shef nuk besoj që ka me marrë vendim pa ju pyet kush po do prej juve. Edhe ti ke qenë asambleist, edhe unë, edhe gjithmonë janë marrë këtu. Por që e diskutove që kanë rrjedhë ato, tash unë po e kuptoj për çfarë arsye edhe e ke bo kërkesën. Besoj që do ta mendoj edhe nesër, para se me fillue seanca, do ta mbajmë një takim. Edhe s'e di sa do të mundën me ardhë shefat e grupeve tjera, por e diskutojmë edhe e shohim. Për mu absolut s'është problem. Atëherë, kush është pro kësaj pikës që nesër të kalojë në Kuvend? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Dragashit. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e shtatë: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ZK Dragash P-70604014-00099-1 me pronën e përbashkët të z.Amir (Ahmet) Jamini, z.Asad (Ahmet) Jamini, Rehjan (Omer) Jamini dhe Nerkes (Omer) Jamini, prona me numër të parcelës P-70604014-00827- 2 ZK Dragash. A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë vazhdojmë me pikën e pestë, të cilën e rekomanduam si KPF, për miratimin e raportit të performancës komunale. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

Artan Loshaj: z.Kryetar, ju përgëzoj për grantin që keni marrë, por kam disa vërejtje, sidomos te superdrejtori, ku prej 11 pikëve, veç dy pikë i ka. Te Financat, mirëpo sot s'po më del këtu, s'po ma qet atë faqen e gjashtë, ku në secilën, në Kuvend, e në drejtori e në shëndetësi, që i kanë pru me pika që ju kanë notue. Menaxhimi financiar, prej tri pikëve, veç një pikë e keni marrë. Te e dyta. Atëherë, të sugjeroj që drejtorit pak me i thënë, e di që është në listë për në Parlament, po Komunën le ta kqyrë ma shumë, te mbledhja e faturave, se këtu më zo të madh ka shkue që ka sukses në menaxhim. Tatimi, niveli i mbledhjes së faturave të tatimit në pronë, pa borxhe, interesa dhe ndëshkime, prej pesë pikë, i

ka zero pikë. Domethënë, 34% veç e ka bo mbledhjen e tatimit. E këtu u krekoske vitin e kaluar, thojke unë e kam rrit buxhetin, e financat, e s'di çka thojke. Edhe te Burimet Njerëzore, prej tetë pikë, i keni marrë zero pikë. A kanë qenë në pushim të lehonisë ata punëtorët, a s'kanë qenë këtu, a s'kanë qenë të qasshëm, a kanë qenë në pushim vjetor, s'po e kuptoj. Një vjet, prej 11 pikë, veç 2 me i marrë, drejtoria edhe mburremi që ne po punojmë, edhe të Burimet Njerëzore, prej 8 pikë, zero pikë. Është një sugjerim i jemi që pak, një troj, kujtoja një troj që janë keq edhe janë dobët. Neve na konvenon si opozitë, po si Komunë pak shumtuet, dy pikë me i marrë, një dysh të shtrembër aty, ose prej 8 pikë, zero pikë me i marrë Burimet Njerëzore. Është mirë që e keni marrë këtë grantin, po një troh pak me jau kujtue, me thënë që kadal pak, punoni ma shumë një troh e mos u merrni me çështje të tjera.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën?

Bexhet Xheladini: Atëherë, siç e dini, ne për herë të tretë si Qeveri Komunale jemi fitues të Grantit të Performancës. Edhe vitin e kaluar kemi qenë fitues po kemi pas 28 pikë, kësaj radhe i kemi 54, do të thotë i kemi dyfishue. Por ne e kemi fitue, ju s'e keni fitue asnjëherë. Ëshë me rëndësi me e fitue, është me rëndësi edhe sa më shumë pikë me pas, por janë disa kushte të cilat, as qeveria e kalume as ne, edhe qeveria e ardhshme nuk mundën me i plotësue. Te tatimi në pronë nuk është faji i qeverisë, por është faji i atyre të cilët e bëjnë pagesën ose mospagesën e tatimit në pronë. Sa i përket atyre pikëve që thatë për burimet njerëzore. Aty poentohet përqindja e pjesëmarrjes së grave në pozita udhëheqëse. Ne atë përqindje nuk kemi mund me e arrit. Këtu për me fitue poena duhet me qenë mbi 50% të grave në pozitë udhëheqëse. Gjithashtu, përqindja e grave të punësuar, edhe aty nuk kemi marrë poena, për arsye se duhet me qenë mbi 50% në bazë të ligjit. Kështu që, këtu ne më së shumti kemi hup poena, sepse përndryshe e kishim mbërri edhe gati 90-shin. Janë disa parametra që edhe vitin e ardhshëm ne nuk mund t'i bëjmë. Besoj se edhe vitin e ardhshëm do ta fitojmë Grantin e Performancës, do të ketë ndoshta ngritje, por jo aq të madhe sa ne dëshirojmë, sepse janë disa parametra të cilët ne nuk mund t'i plotësojmë. Pse e kemi qit në rend të ditës këtë pikë? Ne edhe vitin e kaluar, edhe pse e kemi diskutue performancën, në poentim nuk kemi marrë pikë, gjoja se ata kanë kërkuar që të bëhet edhe një procesverbal, të bashkëngjitet procesverbali i Asamblesë Komunale ku është diskutue për këtë çështje. Për këtë arsye ne e kemi qit në rend të ditës. Kur e kemi pa që ata nuk na kanë pranue vetëm pse e kemi dërgue në Ministri rendin e ditës ku është debatue, kështu që kësaj radhe do t'a bashkëngjesim edhe procesverbalin, dhe pastaj sigurisht do të fitojmë pikë vitin e ardhshëm për këtë, për arsye se planifikojmë prapë të konkurrojmë për të qenë fitues. Kështu që, për atë arsye ne kemi kërkuar nga ju mirëkuptimin që kjo të futet jashtë pikave të rendit të ditës të cilat i keni marrë me material. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero

abstenim, e miratojmë këtë pikë. Atëherë fillojmë te pika e tretë e KPF-së, te pika eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Kryesuese, në fillim e kam një kërkesë. Dy muaj nuk kemi majt seancë, a bën në vend të Xhemiles edhe nja 10 minuta me m'i falë, se i kam do pyetje pak ma shumë? Pyetja e parë është për ty, kryesuese, edhe për kryetarin. Është një kërkesë nga një qytetar i komunitetit për me e nda një parcelë... atë e kreva, e paskit pas. E kam këtu një foto, bora që ra, trotualet kanë qenë në gjendje të mjerueshme nga qato vazot e drejtorit që i ka lënë aty. A ka mundësi, kryetarit po i them, drejtorit edhe juve, me i hek këto vazot, se pak nuk po i pastroni trotualet edhe ato vazot, pak problem për qytetarët. Kanë ankesa. E lexova në Zytë të Prokurimit, më 4 dhjetor keni qit tender për drutë. A për këtë vit, kryetar, a për vitin e zgjedhjeve, 2025-tën? Edhe në qat pyetje të arsimit, po due me e bo edhe një pyetje. Mirë keni bo që keni fillue me qat konkursin e vonueshëm, superkonkursin, që i keni marrë dy profesora në Gjinnaz – të drejtimit të Shëndetësisë. Javën tjetër përfundon viti shkollor, ato tri gjenerata, gjashtë klasë, kush do t'i notojë? A ka me pas guxim qaj profesori ose profesoresha që ka ardhë me i notue nxënësit? Është mirë me e marrë një informatë. Këtë është mirë edhe nesër, po unë po ju përgatiti për pyetjet, nesër ma lehtë me dalë para qytetarëve, se di edhe me hesht unë. Po unë jam shumë i mirë, se një opozitë e mirë, pak ju kthejll. Një pyetje tjetër e kam, për ndriçimin e fshatit Rrenc, kryetar, është një projekt dyvjeçar. Keni bo një fushatë të dobët, të ulët, ndaj meje, si ekzekutiv. Qat ndriçim që po e bëni, ka qenë me të vërtet si projekt i PDK-së, të cilin e kam kërkuë unë këtu, e di edhe znj. Arijeta, edhe qat projekt prej 2020-tës e keni marrë edhe e keni qit – se keni pritue me bo të ri – të qëllimshëm, e keni qit në tender. Unë po, si asambleist, kam kërkuë me e bo ndriçimin, po unë jam infermier, unë nuk di me bo tendera, me i qit ato, se unë nuk punoj në Urbanizëm. Është një shqetësim i disa qytetarëve, që ju kam thënë në fillim, 30 mijë euro neve na ka kushtue, e ju e keni qit në tender me 20 mijë. Kur e keni pa që nuk po bëhet, e keni bo projekt dyvjeçar, se edhe në mot i keni zgjedhjet. Është një ankesë e disa qytetarëve, që doni me m'ulë – po nuk mundni me m'ulë para qytetarëve të fshatit Rrenc, këtë gabim e keni, se veç që më rritni mu. Këtë e keni bo për vota. Edhe, bash te kryetari i Degës së LDK-së në Rrenc, për dy-tre bandera nuk e keni çue ndriçimin, edhe më thirr në telefon mu, edhe vij unë në Komunë marr informata, atij që i kanë shkruë në email, në shkresë i kanë thënë Artani i ka bo këto. Mu po më vjen mirë që edhe pas tri-katër viteve në pushtetin e juaj po merreni me tenderët e PDK-së edhe tenderët e Artanit. Një ndriçim që e keni bo, rrugët kryesore nuk i keni bo, nashta u konë gabim atëherë i joni, po ju keni ardhë me e përmirësue edhe me e udhëheq ma mirë, jo me udhëheq me tenderët e PDK-së. Se ju jeni lodhë për tri vjet edhe nuk bëni projekte të ri, po ju merreni me qato tonat, sa me kapërcye, se në zgjedhjet tjera me siguri mo opozitën e shihni. Lagjet kryesore, nuk i keni çue banderat aty edhe nuk e keni bo. Po ju bëj një kërkesë, në emër të fshatit, në emër timin. 10%-shin që e keni, vazhdoni rrugët kryesore. Po kryetar, ta bije nesër, ta bije bisedën e zyrtarit tënd – s'po due

me emër – ky projekt është i Artanit. Nuk i Artan Loshajt, i Kuvendit Komunal është, ky është i Komunës, është i Bexhet Xheladinit. Këtë projekt e ka bo Artan Loshaj në 2020-tën, po e kam bo unë në 2020-tën, kam mund me gabue unë, përmirësone ju. Prej 2020-tës në 2025-tën po shkojmë, aty janë marue shumë shpia. Shikoni rrugët kryesore, për shembull Kroi i Balisë është rrugë kryesore, se edhe Arijeta vjen prej atij fshatit. Është rrugë kryesore ku ke ec ti edhe prindërit tanë, demonstratat kur janë bo, në qat rrugë nuk keni bo ndriçim, e keni anashkalue. Rrugën për te Shaban Skeraj, kryetarin e LDK-së që e keni në fshat, për dy bandera nuk e keni bo. Është rrugë kryesore. Edhe kërkoj që të bëhet vazhdimi deri të Lagjja e Hoxhës nalt. Se është rrugë kryesore, është rrugë milionëshe që po investojmë aty, për në Kapre. 15 bandera i keni, se e kam pa projektin, 15 bandera i keni rezervë. Dy shtylla ose tri deri te lagjja tjetër. “Na kemi me i bo, po kqyrne çka ka desht me bo Artani, na e bojmë ma mirë”. Mos, është e ulët, vallahe është e ulët. Për Zotin më boni nder, ishalla merrnu qeshtu me mu, më boni nder vallahe. Hala keni me m’rrit në katund. Edhe shkojmë te e fundit, kryetar. Është edhe kryesuesja dëshmitare këtu, edhe nënkryetari. Ta kam bo një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare – Zyrës për Kthim dhe Komunitete, më ke thënë unë nuk mundi, se është i pavarur, bonja ti kërkesën. Po, unë ia kam bo kërkesën në gjuhën shqipe, në gjuhën amtare, në gjuhën e nënës time, edhe të krejt nënave tona, ai e ka përkthye, i nderumi – ti e marrish tash çështje politike, po jo, nuk është – ai e ka marrë edhe e ka përkthye në gjuhën e vet, serbe a boshnjake, çka po di qysh ndihet ai, s’është problem. Unë e di që ai nesër kur t’i nije këto fjalë, ka me thënë Artani po më sulmon, po jo. Kërkesa ime është kjo, kryetar, nesër kam me ta qit në kamera. Në gjuhën time. I nderumi ma ka kthye në gjuhën serbe. Unë e foli, unë jetoj me goranët, unë e foli serbishten, kroatishten, boshnjakishten, goranqen, i foli krejt edhe jetoj me ta unë. Po ai i nderumi më ka ofendue edhe më ka neglizhue, edhe e ka shkelë Kushtetutën, edhe ma ka kthye në gjuhën serbe. Ti nuk ke qenë, ke qenë në një vizitë private apo zyrtare në Zvicër, kam shkue te nënkryetari edhe i kam thënë që mos ta bëj të madhe – ka qenë prezente edhe kryesuesja – mos ta bëj shumë të madhe, pse ka ndodhë kjo. Pse po më provokoni shumë ulët edhe shumë turp me e bo këtë, në këso mënyra më më provokue. Tha që do ta zgjidhim këtë problem edhe deri më sot, që një muaj ditë, që pesë javë nuk u zgjidhë. Unë atij nuk ia lejoj këtë më m’provokue. Unë po kërkoj nga ti të dalish këtu edhe ta dënosh si rast. Mos të përsëritet ky rast, se unë di me e mbrojt veten time, provokimet ndaj meje edhe gjuhën, qato që e foli, se bajagi për këtë gjuhën... mos të bëhem shumë patriot, se bajagi për këtë gjuhën njerëzit kanë sakrifikue me shekuj, e ai me m’provokue, e një bub i gospoxhës – mos të dal taktit – një oficer i veshur me uniformë të Serbisë me m’provokue mu në këtë nivel, nuk ia lejoj, kryetar. Nuk ia lejoj këtë, po të kallxoj. Pyetja e dytë, që e kam përkthye unë, pyetjen e parë që ia kam bo ma ka kthye, për janar-shtator harxhimet. I paska 25 mijë euro buxhet, afër 9 mijë euro paska paga dhe shtesa, ndërsa mallra dhe shërbime 6 mijë euro. Paramendo, kryetar, për nëntë muaj ditë shtatë herë i është prish kompjuteri Uzair Hamzës. A unë e di që e keni punëtorin që e bën

mirëmbajtjen e internetit këtu. Edhe e ke me data këtu, më 12/02, Avni Haliti B.I. 64 euro mirëmbajtja e teknologjisë informative. Prapë edhe një kontratë, dy, se s'un i ka marrë fatura, se unë e di qysh i bën ai, se unë kam bashkëpunue para jush me të, më 12/02 prapë edhe 50 euro ka bo mirëmbajtje të teknologjisë informative. 6 mijë i ka mallra dhe shërbime, i ka harxhue krejta. 7 herë – mos t'i numëroj – afër 600 euro ka bo mirëmbajtje të teknologjisë. Afër 400 euro ka hongër dreka. Një 500 euro e kish avans, nuk e kuptova unë, avans 500 euro, pare të vogla të xhepit, me iu gjet. Është e pakapshme! 1500 euro e ka bo mirëmbajtjen e automjetit. Për 9 muaj ditë, 1500 euro ka bo. Edhe e dyta, kryetar – se unë e përktheva edhe e di gjuhën pak, pak më ndihmuan, ia kam bo unë kërkesën për tri vitet e fundit, për subvencione të shtëpive për të riatdhesuarit. Përgjigjja e tij ka qenë – se e kam qit në telefon këtu – që unë nuk kam informata për këtë kategori. Ajo është një lojë e tij e flliqtë, qysh di ai me e bo. Se një qytetar i Komunës së Dragashit – qe ku i kemi minoritetin – që ratdhesohet, që vjen në Komunë, sefte lajmërohet në zyrën e tij, edhe shkova me marrë informatë, bashkë ai i ka kap përdore, për vota po i bjer dy për me i regjistruar. Kne thotë nuk kam informata unë, ka Ministria e Kthimit, kne i ka përdore edhe i bjer të riatdhesuarit aty. I ke edhe fotot. Nuk më jep përgjigje mu, kne i ke fotot duke i vu themelet për të riatdhesuarit. Kne mu nuk më jep përgjigje, e ke në foto duke i dorëzue çelësat. Unë s'po e kuptoj, a qaq ka imunitet te ti, me lujt kështu me ne ai a? A qaq e ke të ledhatuar atë a? Unë të thashë edhe një herë, nuk kam me ia lejuar. Në qoftë se ju nuk e dënoni, unë kam me u marrë unë qysh di me u marrë me të. Nuk e lejoj atë me u marrë më këso sende! Edhe një nënpyetje të vogël: A është e vërtetë, kryetar – pak është me spec kjo – qetu që ke qenë, që je takue me minoritetin, në Zvicër, një Safet Kushi paska shkruar – ta ka urue ty që keni bo njëfarë marrëveshje me e nda Komunën e Dragashit në komunën e Gorës dhe të Opojës, edhe ta kish urue zgjedhjet tjera me qenë veç kryetar i komunës së Opojës. A është e vërtetë qekjo, a është me spec edhe e tija? Unë e lexova dhe e përktheva, “selam, pozdrav i tung” ta ka bo, të ka thënë që në zgjedhjet tjera ti ke me qenë veç kryetar i komunës së Opojës. Një marrëveshje është bo, një mirëkuptim në mënyrë vëllazërore, që Komunën me e nda në gjys. Kryetar, nuk po shpifi, që e ke në rrjete sociale, ti shumë merresh me rrjete sociale. A është e vërtetë, na jepni njëfarë përgjigje. Në qoftë se ke bo ndonjë marrëveshje, na kallxo bre burrë.

Munir Jonuzi: Doja të vazhdoja me atë që tha kolegu im Artani. Me sa kuptoj, ai ka marrë përgjigjen se zyra për komunitete nuk ka lidhje me ndërtimin e shtëpive për komunitetin jo-shumicë. Më lejoni t'ju them menjëherë se kjo nuk është e vërtetë. Lista e të kthyerve të cilëve u janë bërë shtëpitë vjen nga Zyre për komunitete, nuk ka mundësi që vetëm zyra për komunitete ta dijë situatën në terren. Ata u përgjigjën se ne bashkëpunojmë vetëm me zyrën për komunitete. Në këtë mënyrë, lista e të gjitha shtëpive erdhi nga zyra e komunitetit. Është një manipulim dhe fakti që ne nuk kemi lidhje me të është në favor të këtij pretendimi tim. Dhe kur duhet të bëjmë fotografi, ne i bëjmë ato. Ky është politizimi i zyrës së komunitetit. Lista e fituesve të subvencioneve Shtëpitë e të cilëve do të ndërtohen e perpilon

zyra për komunitete.

Bexhet Xheladini: Lidhur me ndriçimin në Rrenc, shumë herë ke diskutue për këtë ndriçim, edhe shumë herë na ke thënë që ekziston projekti, pse nuk po e qitni në tender. Na e kemi qit në tender, ndërkohë është vërejt se tenderi të cilin e ka bo qeveria e kaluar e ka pague kompaninë adekuate për përgatitjen e projektit, mirëpo ai projekti nuk i ka përfshi të gjitha rrugët, të gjitha fshatrat, të gjitha vendbanimet. Kështu që, kur ka fillue procesi i implementimit të projektit, kanë dalë këto pakënaqësitë e qytetarëve të cilët kanë ardhë në Komunë dhe janë ankuar. Normal, ata nuk kanë ardhë me u ankue te ju, po kanë ardhë në Komunë me u ankue pse rruga e tyre nuk është, për arsye se në projekt nuk është. Ne e kemi qit tenderin në bazë të projektit që e kemi gjet nga qeveria e kaluar. Ndriçimi në fshatin Rrenc është projekt dyvjeçar, do ta përfundojmë. Jo pse dikush po kërkon ose ju premtan, po ne do ta bëjmë sepse qytetarët kanë nevojë për ndriçim publik, edhe asnjë prej qytetarëve në fund, kur të përfundojë projekti, kur të bëhet pranimi teknik, nuk do të mbetet pa u përfshi në këtë projekt. Kështu që, askush nuk ka thënë për ju. Unë jo, tjetërkush a ka thënë nuk e di. Ia kanë tregue projektin, që rruga e atij motoristit nuk ka qenë e përfshirë fare në projekt. Kështu që, zyrtari komunal i autorizuar për këtë çështje e ka tregue vetëm projektin edhe normale është që e ka tregue, ai nuk ka gënjye. Megjithatë, ka qenë një gabim, ndoshta tendencioz, ndoshta pa qëllim, nuk e di pse nuk u përfshi ajo rrugë. Sa i përket pyetjeve që i bëtë për Zyrën e Komuniteteve, nesër e kemi seancën, ai vjen këtu dhe do të përgjigjet për të gjitha këto. Ti ia bën edhe një herë atij personalisht pyetjet edhe ai të përgjigjet. Nëse nuk të përgjigjet nesër, ai është i detyruar me t'u përgjigje, sepse e ka edhe atë të drejtë. Askush askënd nuk ka të drejtë me e provokue, për atë unë të thashë nesër ai do të përgjigjet këtu. Nëse jo, do të përgjigjet me shkrim, ose, nëse është i papërgatitur, në seancën e janarit të përgjigjet.

Artan Loshaj: Për Uzairin u morëm vesh, nesër na premtove që do të del në foltore. Për ndriçimin, kryetar, mirë keni bo që po e bëni. Pse bre, sikur pula kur e bon një vo, po e bëni shumë të madhe me marrë vesh mahalla edhe katundi. Pse bre një herë nuk e keni marrë qato që e kemi bo, na kemi bo gabime, na ka dënue qytetari. E pranojmë na. Po pse kur e ke marrë ti, pse e ke bo veç copy, le t'ia shojke bre një sy ja dy minuta. Se për pesë vjet që është bo, ai ka ndryshime. Ka ndryshime katundi, se për pesë vjet janë ndërtue 20 shpia. Del në vend të ngjarjes, kqyre projektin, kie inxhiniera, kie njerëz të shkolluar, që i ke marrë në punë. Edhe e kam lut unë mbikëqyrësin e projektit, më ka thënë javën tjetër. Qe sot kam me shkue me e kqyrë, në vend të ngjarjes me dalë. Unë kam bo gabim, na kemi të drejtë me gabue, edhe po e pranojmë, gabojmë na. Kemi gabue, na ke mund, ke fitue, për hajr të koftë! Udhëhiq! Prapë nëse shkon mirë, edhe katër vjet merre. S'jemi kundër na, ajo është garë, mas garës unë ta jap dorën, udhëhiq edhe 20 vjet ti. Ama kjo është e qëllimshme, ju dhëm juve. Jo ty, se s'po due me emra me i përmend ata që s'janë këtu. Ju, ekzekutivi, e keni marak me u marrë me fjalë të çajtoreve. I ekzekutivit, drejtori yt është, nesër kryetar ta bie bisedën. Screenshot e marr, ta bëj me ngjyra edhe ta

printoj, ta bije qetu. Nuk të rrej unë edhe ti ma ngjohish karakterin tem. Jam shumë i drejtpërdrejtë. Me emër e mbiemër nuk po due me i qit. Drejtori yt, zyrtari yt, e ka marrë, e ka qit, e ka shti, qaj drejtor që ka punue me ne. Bean Hadziasani është dashtë me ia lëshue një sy, inxhinierat tu që i kie, arkitekta a çka i kie poshtë. As s'e keni kqyr çka po qitni. E keni kqyre shumë mirë, po e keni bo kuse s'po shihni. Rrugën kryesore ku ti ke dalë në protesta, ku ti ke ardhë në komë në Dragash, në Pazar, prind e tu edhe prind e tanë. Rruga kryesore nuk u bo, kryetar. Unë nuk e kam bo atë, unë e kam kërkue, unë nuk boj projekte, o kryetar. Qat drejtorin ti që e ke poshtë, qaj u konë edhe i joni. Qaj qysh n aka zajeb neve po manipulon edhe me ty. Unë nuk bëj, ti e dish rolin e asambleistit. Unë kam bo kërkesë, po nuk di unë, më pas konë kisha punue në Urbanizëm, me ditë me bo projekte të mira qysh po mendoni ju. Unë nuk po të akuzoj ty, unë po e akuzoj drejtorinë tënde. Mos, se kjo është e ulët. Edhe mu më thoni merrshe me fjalë të kafeneve. Superdrejtorat tu merren me sende shumë të ulëta, për një grusht vota. Mosni, se gabim e keni! Zegjedhjet tjera kanë me kallxue, se me këto nacionalet shumë nuk merrem, zgjedhjet lokale prapë e shihni kush e qysh.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër? Atëherë edhe Artani e tha, po edhe mu më është drejtue një kërkesë prej një banori të Zlipotokut, z.R.S., ka kërkuar për me ia dhënë një tokë për me ndërtue një shtëpi. Siç e dini, Kuvendi Komunal nuk e ka të drejtën që me iu dhënë tokë personave fizikë. Pasi ai është prej komuniteteve, është mirë që t'i qaset Zyrës për Komunitete.

Artan Loshaj: znj.Kryesuese, unë kam pyet, po qeky personi ia ka bo komiteteve, dy komiteteve, kryetarit dhe Kuvendit, se nuk ish votues i Uzairit. Tha s'un po ia çoj Uzairit, se nuk merret me mu ai, merret veç me votuesit e vet. Unë qe e kam në telefon, veç special nëse e ke bo ti. Unë një kërkesë që e kam, ishalla gabim jam ... Arijetë, seriozisht po të lutem, se nuk kam kushte unë kështu me e vazhdue seancën, a po e ndalish, unë jam duke bisedue, mos e lë prej aty me ndërhy. Unë jam në Komitet, nuk është drejtori këtu. Jo, nuk mundesh me e ndalë, se mu më ka pru dikush këtu, unë e përfaqësoj dikënd këtu. Me këtë kërkesë që e kam unë, dy komiteteve, Kuvendit edhe kryetarit. Nashta ka edhe ndonjë kërkesë tjetër. Uzairit mundesh me ia çue ti, po nuk i është bërë Zyrës. Veç nëse e keni ndonjë kërkesë tjetër. Qekjo kërkesë unë që e kam të protokolluar, është për katër: dy komitetet, kryetarin edhe Kuvendin. Nuk paska të drejtë Kuvendi Komunal me i nda, me siguri ia jepni një përgjigje.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër? Në qoftë se jo, atëherë e mbyllim këtë mbledhje të KPF-së! Shihemi nesër në seancë!

Kryesuesja e Kuvendit

Arijeta Skeraj